

# STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Hoti Invest” Shpk

Sot, më datë 20/06/2025, në Elbasan, në prani të:

**Z. Laert Hoti**, i biri i Xhemal, qytetar shqiptar, lindur në Elbasan, më 11 Shkurt 1986, me banim në Lagjja Kongresi Elbasanit, P. 36/2, K. 3, Ap. 9, Elbasan, Shqipëri, me numër personal I60211078E,

i cili ka vendosur me vullnet të lirë dhe bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008, ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të nënshkruajë Statutin dhe akt themelimin e mëposhtëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Hoti Invest" shpk, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

## KAPITULLI I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

### Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "**Hoti Invest**" shpk (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

### Neni 2 – Emërtimi

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është “**Hoti Invest**” Shpk. Shoqëria në vazhdim do të identifikohet përveç të tjerash edhe nga logo, vula dhe shenja dalluese apo marka tregtare.

### Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria do të operojë në fushën e (i) investimit në instrumenta financiar (të cilat përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimi në pasuri të paluajtshme, të luajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përbushjes së objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së shoqërisë.

#### **Neni 4 – Selia**

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në: Lagjja Kongresi Elbasanit, P. 36/2, K. 3, Ap. 9, Elbasan, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar
- 5.2. Shoqëria mund të priset më parë ose në një tjetër datë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

### **KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuota/pjesë, e nënshkruara, me vlerë nominale 100'000 (njëqind mijë) lekë.

#### **Neni 7 – Kontributet**

- 7.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është 1(një) kuotë që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë ose shuma 100'000 (njëqind mijë) lekë dhe është në pronësi të Z. LAERT HOTI.

#### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

- 8.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 8.2. Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre. Në rast se një apo disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët që i rezervohen atij/atyre në rritjen e kapitalit mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

#### **Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar nga ligji.

- 9.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruar prej tyre.

#### **Neni 10 – Transferimi i kuotave**

- 10.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2. Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët.
- 10.3. Kuotat janë lirisht të transferueshme për shkak trashëgimie *mortis causa*. Nuk ka asnjë ndalim për transferim të kuotave kundrejt çdo personi apo subjekti të interesuar.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL**

#### **Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj**

- 11.1. Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërtimin dhe/ose shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe për çdo çështje tjetër parashikuar nga ku Statut apo nga legjislacioni në fuqi.

#### **Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve që ai zotëron.
- 12.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me autorizim me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

#### **Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet.**

- 13.1. Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë të shihet e nevojshme nga Drejtimi dhe vetë Ortaket apo Eksperti Kontabel i shoqërisë por jo me pak se dy herë në vit.
- 13.2. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën postare, elektronike apo në dorë, sipas deklaratimit që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe atë të ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7(shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi rendin e ditës që do të trajtohen dhe për te cilin do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.
- 13.3. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e kourumit të parashikuar në pikën 13.5 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 10 (dhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

- 13.4. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të nderhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari, në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari I mbledhjes. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.
- 13.5. Asambleja e Përgjithshme do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, të cilët janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.
- 13.6. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë shumicën e cilesuar në ligje të kapitalit themeltar.

#### **Neni 14 – Administrimi dhe Kompetecat e Administratorit**

- 14.1. Administrator i shoqërisë për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe me të drejtë riemërimi do të jetë: Z. Laert Hoti, i biri i Xhemal, qytetar shqiptar, lindur në Elbasan, më 11 Shkurt 1986, me banim në Lagjja Kongresi Elbasanit, P. 36/2, K. 3, Ap. 9, Elbasan, Shqipëri, me numër personal I60211078E. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 14.3. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme,
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare,
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,
  - d) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim,
  - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
  - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe te publikojë cdo vendim që ka efekte per shoqerine,
  - g) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
  - h) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

i) Cilido qoftë sistemi i administrimit, organi administrativ është i veshur me pushtetin më të gjerë për administrimin e shoqërisë, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara nga ligji, të përfshira në marreveshjen e ortakëve për emërimin.

j) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Administratori është i detyruar të zbatojë vendimin e ortakut të vetëm, kjo edhe në rastet kur mendimi i tij është i ndryshëm

k) Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 15 – Audituesi Ligjor**

15.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo emërohet nga Asambleja e Përgjithshme, kontroll i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa audituesve ligjorë.

## **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 16 – Viti financiar dhe bilanci vjetor**

16.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit, kjo përveç vitit të parë financiar që fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe perfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

16.2. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 17 – Fitimet**

17.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat apo pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.

17.2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të ndryshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve plotësisht ose pjesërisht për vitet financiare të ardhshme.

## **KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18 – Prishja**

18.1. Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme,

- me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2. Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

### **Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1. Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.
- 19.2. Për te administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimit.
- 19.3. Me përfundimin e procedurës së likujdimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likujduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likujdimit.
- 19.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likujdatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likujdimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

### **Neni 20 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 20.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 21 – Gjuha**

- 21.1. Ky Statut është hartuar në 3(tre) kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara dhe pranuar nga pala prezente.
- 21.2. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.

ORTAKU I VETËM SHOQËRISË  
“Hoti Invest” Shpk

Z. LAERT HOTI